

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6394
E hënë, 23 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Qeveria e Kosovës zgjeron listën e afganëve që do të strehojë përkohësisht

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ENDE ASNJË REAGIM I INSTITUCIONEVE SHITËTËRORE NDAJ VËNIES SË GURTHEMELIT TË TË ASHTUQUAJTUR "UNIVERSITETI I PRISHTINËS" ME SELI NË MITROVICËN E VERIUT

FAQE 4-5

QEVERIA HESHT PËR UNIVERSITETIN NË VERI



Opozita ka kritikuar heshtjen e qeverisë Kurti përballë fillimit të ndërtimit të të ashtuquajturit "Universiteti i Prishtinës" me seli të përkohshme në veri të

Mitrovicës të cilin do ta financojë Qeveria e Serbisë. Përfaqësuesit e subjekteve opozitare kanë vlerësuar se ndërtimi i këtij objekti po bëhet

në pajtim me qeverinë Kurti. Sipas tyre, me këto veprime qeveria Kurti po i ringjallë strukturat ilegale serbe në veri të cilat ishin shpërbërë më herët

AKTUALE



ISH-KRYEMINISTRI BLAIR: E PANEVOJSHME TËRHEQJA USHTARAKE NGA AFGANISTANI

F.2

NË PLAZHIN E VELIPOJËS VDES ZYRTARI POLICOR I KOSOVËS

F.7

KOMUNA E PEJËS I SHKRUAN GABIMISHT EMRAT E HERONJVE TË KOMBIT

F.6



EKONOMI



PHOTO: "Epoka e re"
PLOT PRODHIME SERBE NË PRISHTINË GAROJNË MES TYRE, NDONËSE ME ÇMIME DYFISHE

F.8

AEROPORTI 'ADEM JASHARI' KËRKNON NGA UDHËTARËT T'U PËRMBAHEN RREGULLAVE

F.8

Rëndohet situata me pandeminë në Kosovë, edhe 11 të vdekur nga Covidi



Me besim në Zotë ne Atë dhe në Shtet
Haradinaj kërkon dorëheqjen e Kurtit

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepgjisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ish-kryeministri Blair: E panevojshme tërheqja ushtarake nga Afganistani

LONDËR, 22 GUSHT - Ish-kryeministri britanik Tony Blair, i cili ka çuar trupat ushtarake në luftë në Afganistan në vitin 2001, e ka konsideruar tërheqjen ushtarake të Perëndimit nga ky shtet si “të rrezikshme” dhe “të panevojshme”.

Blair ka thënë se Rusia, Kina dhe Irani do të “përfitojnë” nga largimi ushtarak i Perëndimit, pas 21 vjetëve të luftës dhe sulmeve terroriste.

Blair i ka bërë këto komente në një deklaratë të publikuar në faqen e tij Fondacioni “Tony Blair” për Ndryshime Globale. “Braktisja e Afganistanit dhe njerëzve të tij është tragjike, e rrezikshme, e panevojshme dhe nuk është as në interesat e tyre, as në tonat”, ka vlerësuar ai në komentet e para publike rreth krizës prej kur talebanët kanë marrë pushtetin dhe kanë rrëzuar qeverinë e përkrahur nga Perëndimi.

Ai ka shtuar se “pyetja që duhet të bëhet nga aleatët, por edhe nga armiqtë, është se ‘a e ka humbur Perëndimi gatishmërinë e tij strategjike?’”

“Si lider i shtetit tonë, kur kemi marrë vendim që t’u bashkohemi Shteteve të Bashkuara për t’i rrëzuar talebanët nga pushteti - e kush ka parë shpresat e mëdha për atë se çfarë mund të arrihej për njerëzit dhe botën e di më mirë se shumëkush sa të vështira janë vendimet e udhëheqësve dhe sa e lehtë është që të kritikohesh dhe sa e vështirë është të jesh konstruktiv”.

Ai i ka bërë thirrje Perëndimit “që të evakujë dhe t’i strehojë ata për të cilët ka përgjegjësi ata afganë që na kanë ndihmuar, kanë qëndruar afër nesh dhe kanë të drejtë të kërkojnë që t’u qëndrojmë afër”.

Udhëheqësia e lartë e talebanëve është raportuar të jetë mbledhur në Kabul më 21 gusht, për ta analizuar qeverinë e ardhshme, pas kthimit të grupit islamist në pushtet. Talebanët kanë premtuar udhëheqësi “ndryshe” në krahasim me periudhën e fundit sa kanë qenë në pushtet më 1996-2001, kur kanë udhëhequr përmes një interpretimi të ashpër të ligjit



islamik.

Talebanët kanë pretenduar fitore më 15 gusht, pasi kanë marrë kontrollin e kryeqytetit, Kabulit, pas gati 20 vjetëve të dhënies fund të pranisë ushtarake të forcave të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara.

Qeveria ka rënë dhe presidenti Ashraf Ghani ka ikur nga shteti. Talebanët kanë fituar kontrollin

e Afganistanit pak ditë para afatit të fundit - 31 gusht - për tërheqje të forcave ndërkombëtare nga ky shtet.

Forcat e udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara kanë rrëzuar talebanët nga pushteti në tetor të vitit 2001.

Talebanët kanë qenë duke strehuar atëbotë Osama Bin Laden dhe figura të tjera të Al-

Kaidës, të lidhura me sulmet e 11 shtatorit të po atij viti në Shtetet e Bashkuara.

Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se tërheqja amerikane tani është e arsyeshme, pasi forcat amerikane janë siguruar që Afganistani nuk do të bëhet më bazë për xhihadistë të huaj që të kryejnë komplotë kundër Perëndimit.

Merkel në Kiev: Gazi natyror nuk duhet të shndërrohet kurrë në “armë gjeopolitike”

KIEV, 22 GUSHT - Kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë se gazi natyror nuk duhet të përdoret kurrë si armë gjeopolitike dhe ka përkrahur zgjatjen e marrëveshjes për partneritet strategjik me Ukrainën kur ajo të skadojë më 2024.

Merkel i ka bërë këto komente më 22 gusht në një konferencë për media në Kiev me presidentin ukrainas Volodymyr Zelenskiy.

Merkel është duke realizuar vizitën e saj të fundit në Ukrainë, para se t’i përfundojë mandati, pas zgjedhjeve që mbahen në Gjermani muajin e ardhshëm.

Vizita e saj në kryeqytetin ukrainas vjen dy ditë pas takimit që ka zhvilluar me presidentin rus,



Vladimir Putin në Moskë.

Merkel është kritikuar për mbështetje të projektit Rrjedha Veriore 2, për të cilin Kiev,

Uashingtoni dhe disa vende të tjera paralajmërojnë se do ta forcojnë pozitën e Moskës në Evropë sa i përket energjisë. Në

konferencën për media, Zelenskiy ka thënë se bisedimet për zgjatje të marrëveshjes për transit të gazit me Rusinë janë të paqarta. Ai ka thënë se dëshiron të kuptojë se ku mbetet Ukraina pas skadimit të marrëveshjes më 2024.

Merkel ka qenë mbështetëse kyçe e Kievit prej kur Rusia ka aneksuar rajonin ukrainas të Krimesë dhe ka nisur t’i mbështesë formacionet separatiste në disa pjesë në lindje të Ukrainës më 2014.

Si pasojë e këtij konflikti kanë vdekur 13 200 persona.

Merkel ka thënë, në një konferencë për media, se ajo do të vazhdojë “të punojë për integritetin territorial të Ukrainës”

derisa të jetë në pushtet.

Megjithatë, Merkel është kritikuar për qëndrimin e saj ndaj Rrjedhës Veriore 2, projekt që do t’i dyfishojë furnizimet me gaz natyror nga Rusia në Gjermani.

Më herët, gjatë këtij viti, Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara kanë arritur marrëveshje për Rrjedhën Veriore 2, duke u dhënë fund mospajtimeve për projektin pothuajse të kompletuar që mundëson dërgimin e gazit natyror të Rusisë në Gjermani, nën Detin Baltik.

Berlini dhe Uashingtoni janë pajtuar për ta mbështetur bashkërisht Ukrainën, si dhe për ta luftuar Rusinë nëse e shfrytëzon energjinë për presion politik.

Dy baza ushtarake në Spanjë do të strehojnë refugjatë afganë

MADRID, 22 GUSHT - Shtetet e Bashkuara dhe Spanja janë pajtuar që t’i shfrytëzojnë bazat ushtarake në Spanjë, për t’i dërguar atje afganët që kanë punuar për Qeverinë amerikane. Presidenti amerikan Joe Biden dhe kryeministri spanjoll Pedro Sanchez kanë arritur këtë pajtueshmëri përgjatë një bisede telefonike, ka njoftuar qeveria

spanjolle më 22 gusht. Sipas marrëveshjes, bazat - Moron de la Frontera, afër Seviljes dhe Rota afër Kadizit, do të shfrytëzohen për refugjatët nga Afganistani, derisa të rregullohet dokumentacioni për udhëtim në ndonjë shtet tjetër.

Sanchez ka thënë, përmes një postimi në “Twitter”, se ka zhvilluar bisedë kuptimplote me

presidentin Biden. “Kemi përmendur disa çështje me interes të përbashkët, sidomos situatën në Afganistan si dhe bashkëpunimin në mes qeverive tona për evakuim të njerëzve nga ai shtet”, ka thënë Sanchez. Një aeroplan me 11 refugjatë afganë dhe familjet e tyre ka arritur në bazën ushtarake jashtë Madridit më 21 gusht.



Rëndohet situata me pandeminë në Kosovë, edhe 11 të vdekur nga Covidi

Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të dielën 11 viktime nga Covid-19. Në 24 orët e fundit janë regjistruar edhe 1 682 raste të infektimit, pas testimit të 10 710 mostrave. Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se më 22 gusht janë shëruar edhe 263 pacientë nga Covid-19, kurse raste aktive janë 19 695

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 GUSHT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të dielën se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, nga 10 710 testime, 1 682 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shënuar 11 raste të vdekjes.

Të dielën janë shëruar edhe 263 qytetarë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve është

107 288.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 19 695.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 18 776 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 707 793 doza të vaksinës. Deri më sot 236 405 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të dielën se në spitalet e përgjithshme

në Kosovë, si dhe në klinikat për trajtim të koronavirusit, janë të shtrirë 858 pacientë, prej tyre 776 me Covid. Sipas ShSKUK-së, 32 pacientë janë në gjendje të rëndë dhe 664 po trajtohen me oksigjenorapi.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKSHPK) u ka bërë thirrje të dielën qytetarëve që të zbatohen masat e rekomanduara nga ky institut: vendosja e maskës, higjiena, distanca dhe vaksinimi. "Qytetarë të dashur! 'Delta' variantit ia kemi ndaluar turrin edhe pse akoma po raportohen shumë raste pozitive dhe shumë vdekje duke shprehur ngushëllime për të gjithë familjarët. Virusi bartet shumë shpejt prej një personi në dhjetëra persona të tjerë me pasoja që në të shumtën e rasteve mund të jenë fatale e që, fatkeqësisht, preken edhe fëmijët. Andaj ju lutemi të zbatoni masat e rekomanduara nga IKSHPK-ja. Vetëm së bashku do ta rrafshojmë lakoren epidemike dhe do ta ndalim tërbimin e virusit SARS CoV-2. Bashkë me masat tashmë të njohura: bartja e maskave, mbajtja e distancës dhe mbajtja e higjienës, do të arrijnë efektin e vet në uljen e lakores. Ju lutemi të besoni se masa më efikase në luftë kundër Covid-19 është vaksinimi!", është bërë me dije në njoftimin e IKSHPK-së.

Nga 20 gushti në Kosovë kanë nisur së zbatuari masat e reja për luftim të pandemisë. Ahengjet dhe dasmat janë anuluar, është zvogëluar orari i bizneseve të gastronomisë, si dhe është shtuar kërkesa për dëshmi të vaksinimit për të fituar qasje në një mori aktivitete.



Haradinaj kërkon dorëheqjen e Kurtit

EPOKA ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka kërkuar të dielën nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, që të japë dorëheqje. Në një konferencë për media lideri i AAK-së ka thënë se Kurti duhet të japë dorëheqje, sepse sipas tij, ka dështuar në procesin e vaksinimit kundër Covidit. "Po i kërkoj Kurtit të japë dorëheqje si alternativë për shkak të mosseriozitetit të tij në vaksinim. Bota po e jep edhe dozën e tretë të vaksinës e ne jemi këtu ku jemi", ka thënë Haradinaj.

Ish-kryeministri Haradinaj është shprehur i shqetësuar me rritjen enorme të numrit të infektuarve me Covid në vendin tonë. "Shifrat janë alarmante dhe janë më të mëdhatë që nga marsi i vitit 2020, pra jemi duke shprehur shqetësimin tonë në

mënyrën se si po menaxhohet sfida ose rreziku më i madh", është shprehur ai.

Duke folur rreth vaksinimit, Haradinaj ka thënë se vendet e rajonit janë treguar më serioze në vaksinimin, e Kosova jo. "Në Kosovë jemi diku rreth 12 apo 13 për qind dhe të qëndrojmë neutralë. Kjo nuk është e pranueshme. Ne i kemi disa kërkesa për qeverinë. Të fokusohet në vaksinim dhe ta trajtojë gjendjen si emergjente dhe mos ta shpërfillë gjendjen siç e ka shpërfillur deri më tani me kandidaturën e ministrit të Shëndetësisë. Është legjitime kërkesa për dorëheqjen e Vitisë. Faji nuk është i tij, por i shefit të tij. Apeloj te Kurti se, nëse ky është kualiteti se si ai do të përballet me sfidat, më mirë është të japë dorëheqje sot", ka deklaruar Haradinaj.

Ndërsa deputeti i AAK-së, Shemsedin Dreshaj, ka pohuar se si parti i rekomandojnë



qeverisë që ta përshpejtojë procesin e vaksinimit dhe t'i kthejë në punë 600 infermierët. "Qeveria duhet ta përshpejtojë vaksinimin dhe të shpëtojë jetë.

Qeverisë i rekomandojmë themelimin e një shtabi emergjent për menaxhimin e pandemisë. Po ashtu, i rekomandojmë kthimin në punë

të 600 infermierëve që i largoi nga puna. Pra, kjo qeveri duhet ta konsiderojë prioritet shëndetësinë në vend", ka deklaruar deputeti Dreshaj.



ENDE ASNJË REAGIM I INSTITUCIONEVE SHETËRORE NDAJ VËNIES SË GURTHEMELIT TË TË ASHTUQUAJTUR
“UNIVERSITETI I PRISHTINËS” ME SELI NË MITROVICËN E VERIUT

Qeveria hesht për universitetin në veri

Opozita ka kritikuar heshtjen e qeverisë Kurti përballë fillimit të ndërtimit të të ashtuquajturit “Universiteti i Prishtinës” me seli të përkohshme në veri të Mitrovicës, të cilin do ta financojë Qeveria e Serbisë. Përfaqësuesit e subjekteve opozitare kanë vlerësuar se ndërtimi i këtij objekti po bëhet në pajtim me qeverinë Kurti. Sipas tyre, me këto veprime qeveria Kurti po i ringjallë strukturat ilegale serbe në veri të cilat ishin shpërbërë më herët

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 GUSHT - Kanë kaluar dy ditë që Serbia ka filluar ndërtimin e objektit të përhershëm të të ashtuquajturit “Universiteti i Prishtinës” me seli të përkohshme në Mitrovicën e Veriut dhe Qeveria e Kosovës nuk ka thënë asnjë fjalë.

Subjektet opozitare heshtjen e qeverisë e kanë vlerësuar si pajtim për ndërtimin e këtij objekti. PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja dhe ish-zyrtarë të lartë të Kosovës kanë kritikuar qeverinë Kurti për qasjen ndaj shtetit të Serbisë. Sipas tyre, në këtë mënyrë qeveria Kurti po i rikthen strukturat paralele serbe në Kosovë.

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Ariana

Musliu-Shoshi, ka thënë se ndërtimi i universitetit paralel serb në veri të Mitrovicës po bëhet në pajtim me kryeministrin Albin Kurti. “Ndërtimi i universitetit paralel serb në veri të Mitrovicës po bëhet në pajtim me kryeministrin Albin Kurti. Ai ishte në dijeni për ndërtimin e këtij universiteti serb qysh në fillim të muajit korrik dhe këtë e ka konfirmuar në përgjigjen që ka dhënë në Kuvendin e Kosovës saktësisht më 7 korrik, kur unë e pyeta për ndërtimin e këtij universiteti. Kryeministri përgjigjet që funksionimi i këtij universiteti nuk është legjitim, por ndërtimin e këtij universiteti e vlerëson në të mirë të integritetit të qytetarëve të pjesës veriore në shtetin tonë”, ka shkruar Musliu-Shoshi në llogarinë e saj në “Facebook”.

Më e ashpër në reagim ka qenë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Kjo parti ka vlerësuar se me pajtimin e qeverisë Kurti po delegitimohet shteti i Kosovës. “Me aprovimin e vizitës nga Ministria e Punëve të Jashtme, drejtori i së ashtuquajturës Zyra për Kosovën e Qeverisë së Aleksandër Vuçiqit, së bashku me ministrin e qeverisë së Albin Kurtit, vunë në Mitrovicën e Veriut gurthemelin e ‘Universitetit të Prishtinës me seli të përkohshme në Mitrovicën e Veriut’. Me këtë veprim ata delegitimojnë dhe degradojnë shtetin e Kosovës, duke e nëpërkëmbur njëkohësisht edhe identitetin e Universitetit të Prishtinës. Përpos këtij veprimi degradues, e që përforcon më tutje strukturat paralele në veriun e vendit, edhe më skandalozë

është deklarata e zyrtarëve të qeverisë, përkatësisht e zëvendësministrit të arsimit, Popovci, i cili mban qëndrim se ‘Universiteti i Mitrovicës së Veriut edhe me ligjet e Kosovës është në administrimin e drejtpërdrejtë të komunës së Mitrovicës së Veriut’ dhe se, rrjedhimisht, ai universitet nuk është një strukturë paralele”, është thënë në reagimin e LDK-së.

Kjo parti e ka akuzuar qeverinë Kurti se me këto veprime po i ringjall strukturat paralele serbe në veri. “Zëvendësministri duket se harron se asnjë qeveri deri më tani nuk ka legjitimuar një universitet i cili jo vetëm që kundërligjshëm mban emrin e Universitetit publik të Prishtinës, por edhe vepron e funksionon tërësisht në bazë të ligjeve e planprogrameve të Republikës së Serbisë. Është qeveria Kurti ajo e cila po i ringjall e rigjallëron strukturat paralele dhe që dalëngadalë por, me hapa të sigurt, po i rikthen proceset prapa dhe po e riinstalon Serbinë në Kosovë”, ka vlerësuar LDK-ja, duke shtuar se qeveria Kurti është shndërruar në spektatore të

ngjarjeve që delegitimojnë shtetin. “Qeveria Kurti, me gjithë fuqinë ekzekutive dhe shumicën absolute parlamentare që ka, po lejon që ministrat e saj dhe të Republikës së Kosovës pa dallim, të marrin pjesë në këto aktivitete që delegitimojnë shtetin tonë. Praktikantët janë strukturë e janë shndërruar në spektatorë. Prandaj, ndërmarrja e hapave është e largët këtu. Kryeministri Kurti duhet t’i zëvendësojë deklaratat boshe në Bruksel, me veprime konkrete në territorin e shtetit të tij. Ai duhet menjëherë, dhe pa vonesë, ta shkarkojë ministrin nga radhët e minoriteteve dhe me çdo kusht ta parandalojë ngritjen e universitetit paralel në veri”, ka vlerësuar në reagimin e saj LDK-ja.

Në lidhje me këtë temë, kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të dielën se Kurti po tregohet i pazoti të përballet me Serbinë. I pyetur nga gazetarët për ndërtimin e objektit të përhershëm të të ashtuquajturit “Universiteti i Prishtinës” me seli të përkohshme në veri, Haradinaj ka thënë se ka mjaft

situata ku kryeministri Kurti po tregohet i pazoti që të përballtet me Serbinë.

“Ka mjaft situata ku Kurti po tregohet i pazoti për t’u përballtur me Serbinë. Ky o po i shlyen borxhet, ose po i paguan borxhe Serbisë. Nuk po flasim më për taksën që është hequr dhe për reciprocitetin që nuk është vendosur. Kemi rritje të importit nga Serbia. E kjo flet shumë”, ka thënë ai.

Për fuqizimin e strukturave paralele serbe në veri, qeverinë Kurti e ka akuzuar edhe ish-ministrja për Dialog, Edita Tahiri. Ajo ka bërë me dije se sa ka qenë kryenegociatore e Kosovës në bisedime me Serbinë ka shuar strukturat paralele serbe në veri. “Derisa ne si qeveri dhe unë si

kryenegociatore bëmë shuarjen e strukturave paralele serbe në veri, çfarë po ndodh me këtë qeveri që para syve të saj po ngritën struktura paralele serbe. Hiç më larg se sot Serbia vuri themelet e universitetit paralel në veri...”, ka shkruar Tahiri në llogarinë e vet në “Facebook”.

Kurti dikur thoshte se universiteti në veri nuk është legjitim

Ndonëse Qeveria e Kosovës ende nuk është deklaruar për ndërtimin e objektit të përhershëm të ashtuquajturit “Universiteti i Prishtinës” me seli të përkohshme në Mitrovicë, më 7 korrik kryeministri Albin Kurti kishte

folur në Kuvend të Kosovës për këtë çështje. E pyetur nga deputetja e PDK-së, Ariana Musliu-Shoshi, nëse është në dijeni për ndërtimin e këtij universiteti, shefi i qeverisë kishte thënë se ky universitet nuk është legjitim. “Padyshim se funksionimi i këtij universiteti nuk është legjitim, pasi nuk ka hartuar një statut në përputhje me ligjin për arsimin në komuna dhe nuk është akredituar nga Agjencia e Kosovës për Kreditim, siç e kërkon ligji i arsimit të lartë. Për këtë arsye ky universitet nuk financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe nuk do të financohet derisa funksionimi i tij të jetë në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës. Askush nuk duhet të

ketë dyshim që shteti ynë ka në dispozicion mekanizma për të ndaluar një veprimtari të jashtëligjshme por, gjithashtu, e kemi parasysh se në këtë universitet studiojnë qytetarë të Republikës së Kosovës dhe është interesi ynë që ata të integrohen më shpejt në shtetin tonë”, kishte thënë Kurti.

Serbia të premtën ka filluar ndërtimin e objektit të përhershëm të të ashtuquajturit “Universiteti i Prishtinës” me seli të përkohshme në Mitrovicë, i cili do të kushtojë mbi 6 milionë euro.

Financimi i këtij objekti do të bëhet nga Qeveria e Serbisë përmes Zyrës për Kosovën që funksionon në kuadër të saj. Drejtori i kësaj zyre, Petar Petković, në ceremoninë e

fillimit të ndërtimit, ka thënë se ky është gurthemel i unitetit të popullit serb në Kosovë. “Ky është gurthemel i harmonisë, unitetit të popullit tonë në Kosovë, dhe për këtë sot ne jemi të bashkuar siç ishim dhe do të jemi: edhe Lista Serbe ashtu edhe universiteti ynë dhe shteti i Serbisë. Populli ynë ka të ardhme vetëm përmes këtij uniteti, siç e ka thënë edhe presidenti Vuçiq”, ka thënë Petković.

Ndërtesa do të ketë 10 575 metra katrorë, me kapacitet për pranimin 10 000 studentëve, ndërsa në kuadër të këtij universiteti do të funksionojnë: Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Matematikës, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Ekonomik.

Xhaçka: Shqipëria është e gatshme të strehojë mijëra afganë

TIRANË, 22 GUSHT - Ministrja e Jashtme e Shqipërisë, Olta Xhaçka, ka thënë se vendi i saj është i gatshëm të strehojë mijëra afganë të cilët po evakuohen nga Afganistani, pas marrjes së shtetit nga talebanët. “Gjatë takimit të ministrave të jashtëm të NATO-s kemi diskutuar për situatën në Afganistan. Shqipëria është e gatshme të strehojë mijëra afganë. Kjo është një sfidë për NATO-n. Nëse Shqipëria mund ta bëjë një gjë të tillë, pse mos ta bëjnë edhe të tjerët”, ka shkruar ajo në “Twitter”.

Ministrja Xhaçka ka theksuar se strehimi i afganëve është “obligim” pasi ata kanë punuar me forcat e NATO-s. “Ne mundemi dhe duhet të ndihmojmë. Kjo ka të bëjë edhe me të ardhmen e NATO-s aq sa është edhe mision humanitar”, ka thënë ajo.

Ministrat e jashtëm të NATO-s, pas takimit të mbajtur së fundmi, u bënë thirrje talebanëve që ta lehtësojnë evakuimin e sigurt të mijëra afganëve dhe qytetarëve të huaj nga Afganistani. Ditët e fundit ka pasur raportime se militantët talebanë po pengojnë njerëzit që të arrijnë në aeroportin në Kabul, prej ku po evakuohen me aeroplanë luftarakë afganët dhe shtetasit e huaj.

Shqipëria është në pritje të arritjes së grupit të parë të afganëve të cilët do t’i strehojë përkohësisht derisa atyre t’u rregullohen dokumentacionet e nevojshme për t’u zhvendosur në Shtetet e Bashkuara.

Edhe Kosova, por edhe Maqedonia e Veriut, po ashtu kanë shprehur gatishmëri të tyre që të strehojnë afganët që kanë bashkëpunuar me forcat amerikane.

Më 15 gusht talebanët morën



kontrollin e Kabulit, pasi për një javë morën nën kontroll shumicën e provincave të vendit. Militantët janë zotuar se duan një qeveri gjithëpërfshirëse, e

cila do të bazohet në parimet e Islamit. Ata, po ashtu, kanë thënë se nuk do të hakmerren ndaj afganëve që kanë punuar me forcat e huaja apo për qeverinë e

mëparshme afgane. Trupat ndërkombëtare, të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara, kanë afat që deri më 31 gusht të largohen nga Afganistani. Por,

presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se trupat amerikane mund të qëndrojnë përtej kësaj date derisa të evakuohen të gjithë amerikanët nga Afganistani.

Komuna e Pejës i shkruan gabimisht emrat e heronjve të kombit

PEJË, 22 GUSHT (ER) - Organizata e Veteranëve e Luftës së UÇK-së në Pejë ka reaguar pas gabimeve që janë bërë në tabelat e

rrugëve në këtë qytet me emrat e heronjve. "Analfabetizmi i institucioneve komunale të komunës së Pejës. Nuk ka

dijeni t'i shkruajë as emrat e heronjve të kombit. Sa për informim, në listën e dëshmorëve të Dukagjinit dhe të gjithë Kosovës nuk ka

dëshmorë të UÇK-së Ardian Krasniqi e Sali Çeku. Heronjtë tanë janë Adrian Krasniqi nga Vranoci dhe Sali Çekaj nga Broliqi".



Komuna e Gjilanit fton prokurorinë për hetim të rasteve të zjarreve

GJILAN, 22 GUSHT (ER) - Komuna e Gjilanit u ka bërë thirrje qytetarëve, fermerëve dhe kalimtarëve të rastit, që me kujdes maksimal të sillen ndaj natyrës, pronës publike, asaj private dhe të mos shkaktojnë zjarre sepse do të sanksionohen përmes institucioneve të shtetit dhe përgjegjësisë ligjore.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka theksuar se rastet e zjarrvënies, janë të patolerueshme dhe do të iniciohen në prokurori dhe organe të drejtësisë me të vetmin qëllim për rend dhe rregull në mbrojtje të natyrës, pyjeve dhe pronës pa dallim. "Zjarrvënia është shumë e pakuptimtë për ne kur fermerët

djegin arat pas korrjes së drithërave. Iniciuesit e zjarreve do të sanksionohen nga organet e drejtësisë. Tashmë e kemi rastin e Pogragjës që është duke u marrë prokuroria me të, sikur që edhe rasti i Stublinës do të procedohet për hetim në prokurorinë e shtetit dhe nuk tolerojmë shkatërrimin e pyjeve dhe të hapësirës publike, sepse kështu shkaktohet rrezik i përgjithshëm dhe rrezik i jetës së qytetarëve. Rojet e pyjeve kanë detyrë ekzekutive që t'i ruajnë me çdo mjek dhe çdo kusht pyjet tona. Përkrahja e komunës së Gjilanit dhe organeve të rendit është maksimale për kryerjen e detyrës së tyre zyrtare", ka thënë Haziri.



Kurti pret në takim listën e iniciativës së përbashkët qytetare 'Mitrovica'



PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka pritur të dielën në takim listën e iniciativës së përbashkët qytetare "Mitrovica". Sipas një njoftimi të LV-së, Kurti ka përgëzuar pjesëtarët e kësaj liste për bashkimin përtej dallimeve jo vetëm partiake në shërbim të interesit qytetar, duke shprehur kështu nevojën e madhe që të përforcohet pozita e komunitetit shqiptar dhe komuniteteve të tjera joserbe në atë zonë. "Kandidati për kryetar të komunës veriore të Mitrovicës, Erden Atiq dhe bartësi i listës, Skënder Sadiku, duke njoftuar për iniciativën e asaj ane, kërkuan përkrahje nga kryetari Kurti sepse, siç u shprehën ata, kjo është hera e parë e një formati të tillë të organizimit, pra të gjitha partitë shqiptare, shoqëria civile dhe Vakati së bashku për një qeverisje lokale ndryshe", ka njoftuar Lëvizja Vetëvendosje.

Shkolla "17 Shkurti" në Banjë pranon donacion një kabinet të informatikës

MALISHEVË, 22 GUSHT (ER) - Shkolla "17 Shkurti" në Banjë ka pranuar një donacion me pajisje të teknologjisë informative, të cilin e ka dhuruar firma "Hazrolli" përmes përfaqësuesit të saj Burim Hazrolli nga Banja me qëndrim në Gjermani. Në kuadër të këtij donacioni është sjellë një laptop dhe dhjetë kompjuterë statikë. Ky

donacion do të mundësojë funksionimin e kabinetit të informatikës dhe nxënësit dhe personeli arsimor i kësaj shkolle do të punojnë me mundësi më të mira për lëndën e teknologjisë informative. Këta kompjuterë janë ofruar në sajë të angazhimit dhe koordinimit me mërgimtarin tonë Burim Ali Hazrolli, i cili jeton dhe punon në Gjermani

së bashku me vëllezërit e tij, të cilët vazhdimisht po përkrahin vendlindjen e tyre dhe më gjerë me donacione për shkollat tona.

Në momentin e pranimit të donacionit ishin të pranishëm gjenerali Gëzim Hazrolli, familjar i firmës "Hazrolli", drejtori i Arsimit, Blerim Thaçi, me zyrtarë nga DKA-ja dhe drejtori i shkollës Izahir Begaj.



Qeveria e Kosovës zgjeron listën e afganëve që do të strehojë përkohësisht

PRISHTINË, 22 GUSHT - Qeveria e Kosovës ka miratuar të shtunën vendimin për zgjerim të listës së personave që do të strehojë përkohësisht nga Afganistani si pasojë e krizës në këtë shtet. Sipas vendimit të 21 gushtit, përveç personave që janë në listën e aplikimit për viza speciale të imigrimit në Shtetet e Bashkuara, mbrojtje e përkohshme do t'u ofrohet edhe personave të kualifikuar në grupin me prioritet të dytë si dhe familjeve të tyre. Departamenti Amerikan i Shtetit ka njoftuar më 2 gusht se punëtorët aktualë dhe ata që kanë punuar në agjenci amerikane apo agjenci që pranojnë fonde amerikane, tani do të mund të aplikojnë për statusin e refugjatit në Shtetet e Bashkuara. Punëtorët dhe ish-punëtorët e qeverisë amerikane apo ata të operacioneve ushtarake të NATO-s, që nuk përmbushin kriteret për programet speciale për viza, janë të përfshirë në listë, ka thënë Departamenti Amerikan i Shtetit. Krijimi i listës "Prioriteti 2", për afganët brenda Programit të Pranimit të Refugjatëve, do të

mbulojë afganët dhe familjarët e tyre që "mund të jenë në rrezik për shkak të bashkëpunimit me ShBA-në", mirëpo nuk janë në gjendje të aplikojnë në programin special për viza të imigrantëve, meqë nuk kanë punuar drejtpërdrejt për qeverinë afgane.

Departamenti Amerikan i Shtetit ka thënë se ky program nënkupton se "mijëra afganë" dhe familjet e tyre kanë mundësi të kenë leje të qëndrimit të përhershëm në Shtetet e Bashkuara si refugjatë. Situata në Afganistan është përshkallëzuar nga 15 gushti, kur talebanët kanë fituar kontrollin e kryeqytetit të Afganistanit, Kabulit dhe kanë rrëzuar qeverinë e përkrahur nga Perëndimi.

Përveç Kosovës, edhe vendet e tjera në rajonin e Ballkanit si Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë shprehur gatishmëri për të pranuar përkohësisht afganët.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë për kanalin televiziv britanik "Skynews" se autoritetet po presin informacione lidhur me datën e saktë të arritjes së këtyre



personave në Kosovë.

Talebanët kanë fituar kontrollin e Afganistanit pak ditë para afatit të fundit - 31 gusht - për tërheqje të forcave ndërkombëtare nga ky shtet.

Forcat e udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara kanë

rrëzuar talebanët nga pushteti në tetor të vitit 2001.

Talebanët kanë qenë duke strehuar atëbotë Osama Bin Laden dhe figura të tjera të Al-Kaidës, të lidhura me sulmet e 11 shtatorit të po atij viti në Shtetet e Bashkuara.

Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se tërheqja amerikane tani është e arsyeshme, pasi forcat amerikane janë siguruar që Afganistani nuk do të bëhet më bazë për xhihadistë të huaj që të kryejnë komplete kundër Perëndimit.

Bora Gjorgjeviqi është edhe më faqezi sesa Goran Bregoviqi. Kurti po fshihet përballë këtij provokimi



PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Profesori universitar, Milazim Krasniqi, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook", ka shkruar për performancën e këngëtarit serb Bora Gjorgjeviq në Leposaviq. Krasniqi ka thënë se këngëtari serb Bora Gjorgjeviq është shpallur në vitin 2012 si vojvodë çetnik. Gjorgjeviq së bashku me grupin e tij "Ribla Corba" ka performuar në një festival në Leposaviq. "Për arsye se vjen me gradën e vojvodës çetnik, ai do të duhej të arrestohej në Leposaviq. Pse? Sepse lëvizja çetnike e Drazha Mihajloviqit ka qenë lëvizje nazifashiste.

Ndër të tjera, ka pasur një projekt për zhdukjen e shqiptarëve dhe ka bërë masakra në krahinën e Peshterit. Pse institucionet tona nuk guxojnë të bëjnë asgjë në veri, as me këtë rast?! Kryeministri Kurti, ministri Sfeçla, ministrja Haxhiu duhet të ndihen të gjallë e të mos fshihen përballë këtij provokimi. P. S. Kjo ngjarje e ndyrë nuk e minimizon provokimin me koncertin e Bregoviqit në Korçë. Në fakt, vetëm sa tregon se sa zibidi jemi gjithkrah! (Të pabrekë e hundëpërpjetë, si thotë një fjalë.)", ka shkruar Krasniqi.

Në plazhin e Velipojës vdes zyrtari policor i Kosovës

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Zyrtari policor Hasan Hysenaj ka vdekur të dielën në plazhin e Velipojës. Lajmin e ka konfirmuar familjari Fehmi Hysenaj, i cili ka theksuar se Hasani do të kujtohet gjatë për urtësinë, vizionin dhe shërbimin për vendin. "Me dhimbje dhe pikëllim të madh pranuar lajmin për humbjen e hershme të djalit

të axhës tim Hasan Hysenaj, zyrtar policor, i cili sot u nda nga jeta në Velipojë. Hasani do të kujtohet gjatë për urtësinë, vizionin dhe shërbimin për vendin. Ishte i persekutuar rëndë nga regjimi serb, pasojat e të cilave i vuajti deri sot", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", Fehmi Hysenaj. Edhe policia e Shqipërisë përmes një

komunikate për media ka njoftuar të dielën për vdekjen e zyrtarit policor të Kosovës. "Rreth orës 11:15, në plazhin e Velipojës, shtetasi H. H., rreth 59 vjeç, dyshohet se është mbytur në det. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes", është thënë komunikatën e Policisë së Shqipërisë.



Aeroporti “Adem Jashari” kërkon nga udhëtarët t’u përmbahen rregullave



PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” ka dalë me një njoftim për udhëtarët, për dokumentacionin që kërkohet në aeroport dhe procedurat shtesë që do të hyjnë në fuqi që nga data 23 gusht.

Në njoftimin e Aeroportit të Prishtinës thuhet se nga data 23 gusht të gjithë udhëtarët duhet të jenë në aeroport tri orë para

fluturimit. “Të gjithë udhëtarët duhet të bëjnë gati formularin e hyrjes në vend (Country Entry Form), bazuar në vendet e destinacionit. Ju mund të gjeni kodin QR dhe lidhjet për formularët digjitalë për secilin vend në hyrjen e terminalit të aeroportit, apo mund t’i gjeni në uebfaqen www.limakkosovo.aero para se të arrini në aeroport. Të gjithë udhëtarët duhet të kenë

PCR test negativ jo më të vjetër se 72 orë deri në kohën e fluturimit, apo antigjen test negativ jo më të vjetër se 48 orë deri në kohën e fluturimit, ose kartën e vaksinimit për dy doza vaksinash. Vaksinat duhet të jenë vakcina të pranuar nga BE-ja dhe duhet të kenë kaluar 14 ditë nga doza e dytë. Për ndryshime nga këto rregulla ju lusim që t’i kontrolloni kërkesat e vendit/destinacionit”, është thënë

në njoftimin e ANP “Adem Jashari”. Sipas këtij njoftimi, të gjithë udhëtarët duhet të bëjnë gati të gjitha dokumentet e kërkuara dhe t’i kenë në duar që t’i prezantojnë te personeli në momentin e paraqitjes së tyre. “Udhëtarët që nuk janë në gjendje t’i tregojnë dokumentet e kërkuara në hyrje të terminalit të aeroportit duhet ta lëshojnë rendin dhe pas kompletimit të dokumentacionit duhet të rirreshtohen përsëri. Më tej, miqësisht ju lusim që të kontrolloni sportelet (check-in) në bazë të kompanisë ajrore dhe

numrit të fluturimit dhe jo vetëm destinacionin, sepse ndodh që në të njëjtën kohë ka fluturime për destinacionin e njëjtë dhe duke mos kontrolluar saktë nr. e fluturimit, ndodh që jeni duke pritur në radhë dhe sportelin e gabuar dhe më pas të jeni me vonesë në fluturimin e duhur. E njëjta duhet shikuar edhe gjatë qëndrimit në radhë në dalje për në aeroplan”, ka njoftuar Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”, duke bërë thirrje që pasagjerët të pajisen me maska mbrojtëse kundër Covidit.

Ekonomia gjermane drejt rimëkëmbjes



BERLIN, 22 GUSHT - Ekonomia gjermane ndodhet në rrugëtim për një rimëkëmbje të gjatë dhe më të shpejtë në tremujorin e tretë 2021, nxitur nga kërkesa e brendshme, pasi Produkti i Brendshëm Bruto u rrit 1.5 për qind në tremujorin e dytë. Vala e tretë e infeksioneve me Covid-19 dhe karantina më e gjatë sesa pritej, bënë që ekonomia më e madhe e Evropës të tkurrej me

2.1 për qind në tremujorin e parë të vitit nga fundi i 2020-s. Ministria e Financave ka theksuar në raport se sondazhet e ndjesisë ekonomike dhe treguesit e të ardhmes sugjerojnë për një vazhdim të optimizimit të bizneset dhe për një aktivitet të lartë të ekonomisë në muajt e verës. Rihapja e ekonomisë dhe rënia e rasteve me Covid-19 në nisje të verës kanë rritur

shpenzimet e familjeve, duke sjell një fuqizim të shitjeve me pakicë në muajin maj dhe në qershor. Rimëkëmbja ekonomike në Gjermani ka rritur të ardhurat tatimore, pavarësisht se të ardhurat e akumuluar nga taksat nga janari në korrik 2021 janë ende 1.7 për qind më pak krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin përpara pandemisë në vitin 2019.



Photo: “Epoka e re”

Plot prodhime serbe në Prishtinë garojnë mes tyre, ndonëse me çmime dyfishe

PRISHTINË, 22 GUSHT (ER) - Në kulmin ekstrem të infektiveve në Kosovë nuk vërehet ndonjë krizë për mallrat elementare. Dyqanet e kryeqytetit të Kosovës duken të furnizuara mirë me mallra nga origjina të ndryshme, por me çmime të ngritura dukshëm. Dallimet në çmim nga një shitore në tjetër janë minimale, por e përbashkëta e tyre është ngritja e çmimeve deri afër dyfishit për disa artikuj të domosdoshëm për tryezën e ushqimit. Ndër artikujt elementarë dominojnë prodhimet serbe, madje disa

prodhimesh për një lloj. Ato bëjnë lojën e konkurrencës me njëra-tjetër për ta favorizuar njërin prej tyre dhe eliminuar vajin kroat “Zvijezda”. Vaji serb prej luliedielli “Premium oil” tani kushton 1.65 euro krahas tjetrit vaj serb “Dijamant” prej luliedielli që kushton 1.75 euro, aq sa “Zvijezda” kroate. E njëjta pasqyrë vërehet edhe për llojet e tjera të artikujve elementarë jetësorë. Mijëra biznese private rrezikojnë të mbyllen në Kosovë për shkak të refuzimit qeveritar që t’ua japë ndihmën e votuar nga pakoja e rimëkëmbjes.

Sekreti i mbijetesës së hebrenjve

Nga: Dashnor DERVISHI

Historia njerëzore njih lulëzimin dhe asimilimin e kulturave dhe popujve të ndryshëm. Fqinjët e vjetër, egjiptianët, janë zhdukur; rivalët e vjetër grekë janë të vdekur dhe të varrosur. Nga antikiteti, këtyre dy kombeve moderne sot u ka mbetur vetëm emri; po ashtu, sundimtarët e vjetër romakë u zhdukën. Fenikasit dhe edomitët nuk gjenden askund. Në të vërtetë, asnjë prej kulturave që populluan Lindjen e Afërt biblike, atë djep problematik të civilizimit, besimit dhe fanatizmit, nuk mundi të mbijetonte gjatë dy mijëvjeçarëve të fundit.


Popujt që luajtën një rol të rëndësishëm në skenën e ngarkuar teologjike, në të cilën u luajt drama e madhe e Jezuit, të gjithë kanë ndryshuar. Ndërkohë, në vitin 2000 hebrenjtë festuan dymijëvjeçarin e ditëlindjes së djalit më të njohur në botën hebraike, në tokën ku lindi, u rrit dhe u varros. Jezui, çuditërisht hebre, i mbijetuar ndaj sprovave të përgjakshme të përzgjedhjes natyrore të historisë, vazhdon t'i shërbejë popullit të tij, duke e kthyer Izraelin në një vend pelegrinazhi nga e gjithë bota, të rrethuar nga kushërinjtë e tyre armiqësorë.

Ndërsa në shekullin e 21-të nuk ka asnjë vend ku flitet gjuha e Egjiptit antik ose e Greqisë së lashtë apo edhe latinishtja, në qendër të qytetit të Jerusalemit, vetëm një milje larg Golgotës (kodra ku u kryqëzua Jezui), të rinjtë flasin nëpër rrugët e qytetit me fjalë që do të ishin plotësisht të njohura për Pjetrin, Palin dhe Gjon Batistin.

Si është e mundur që, ndërsa perandoritë u shembën dhe kulturat e tyre avulluan në ajër, ky fis gjeti një mënyrë për të mbijetuar? Çfarë ndodhi me këta njerëz që prodhuan Jezuin, që i bëri ata kaq të guximshëm për të mbijetuar ndër epoka?

Profesori Israel Knohl i Universitetit Hebraik në Jerusalemin, shpjegon se një nga arsyet e mbijetesës së mrekullueshme të hebrenjve, është aftësia unike që ata fituan që në shekullin e 6 p.e.s., pasi u dëbuan nga atdheu i tyre për herë të parë.

Ishte gjatë periudhës së parë të mërgimit, kur pasardhësit e Judesë krijuan një kulturë kombëtare jo të varur nga Toka dhe Mbretëria, por nga një kujtim i një Toke dhe të etur për një Mbretëri të ardhshme. Ndërsa vajtonin buzë lumenjve të Babilonisë, hebrenjtë zbuluan se të kujtonin Zionin, mund të



funksiononte më mirë për ta sesa të jetonin në Zion. Prandaj, duke formuar një kulturë të mbështetur në një kujtim të asaj që kishte humbur dhe një dëshirë për atë që mund të ishte një ditë, judenjtë e mërguar, pa dashje u përgatitën për katastrofat e ardhshme historike. Kështu që, kur fatkeqësitë u ndodhën më vonë, herë pas here hebrenjtë kishin krijuar një imunitet më të mirë brenda vetvetes sesa shumica e fqinjëve të tyre të fuqishëm.

Arsyeja tjetër e mbijetesës qëndron tek ideja e Zotit, i cili qysh në fillimet e para të ekzistencës së tyre kolektive, 2000 vjet përpara lindjes që ndodhi në Betlehem, udhëhoqi hebrenjtë me idenë që ata kishin një marrëdhënie të veçantë, intime, me të Plotfuqishmin. Ata besojnë se vetë Zoti i ka zgjedhur ata dhe se duke qenë dëshmitarë të tij në këtë botë, ata jetojnë nën vulën ekskluzive hyjnore të kujdesjes së tij.

Ndoshta ka vërtet një Zot, që me të vërtetë tregon një interes personal për banorët e Izraelit; në këtë rast, ky shpjegim mund të përfundojë me kaq. Por, edhe nëse kjo ide për një çast ishte empirikisht e gabuar, edhe nëse Zoti monoteist miqësor hebre nuk ishte gjë tjetër veçse një pjesë e mirë e trillimeve hebraike, e gjitha kjo ka shërbyer si një trillim i dobishëm. E dimë shumë mirë që nuk ka asgjë më të rëndësishme sesa besimi në aftësinë personale, për t'u mbajtur në këmbë, kur ecja bëhet e vështirë. Dhe nëse duhet të kalohet nëpër atë që kanë kaluar hebrenjtë në shekujt e urretjes dhe përdhosjes, pa dyshim që kjo ka një avantazh të madh në ruajtjen e përshtypjes, se e gjithë kjo vuajtje nuk është e

rastësishme, jo thjesht një fat i keq, por përkundrazi, është disi e lidhur me faktin e të "zgjedhurit". Se është dhënë një mision, duke u përcaktuar për të qenë një komb nën Perëndinë.

Besimi fetar është një arsye tjetër që ndihmoi mbijetesën e hebrenjve. Megjithë goditjet e fuqishme që kanë marrë në shekuj dhe përpjekjet për t'i shfarosur, hebrenjtë jetuan në sajë të besimit të tyre fetar, ruajtjes së traditave dhe institucioneve të tyre autonome vetëqeverisëse dhe ligjeve të tyre të përmbledhura në librin e shenjtë të Torah. Këto ligje ata i morën me vete kudo që shkuan dhe i aplikuan me fanatizëm në komunitetet e tyre, që nuk u përzënë kurrë me popullatën e vendeve pritëse. E përbashkëta për këto komunitete të shpërndara në të gjithë botën ishte ëndrra për t'u kthyer në tokën e të parëve, në atë krahinë, që në kohën e pushtimit romak u quajt Palestinë dhe ku vazhdonin të jetonin ende bashkëkombës të tyre.

Bibla, sipas disa studiuesve, ishte ajo që i bëri hebrenjtë shumë ndryshe nga të gjithë popujt e tjerë të lashtë të Mesdheut. Sepse, hebrenjtë ishin të vetmit që kishin vendosur një tekst kanonik në thelbin e jetës së tyre shoqërore dhe publike. Ky tekst, Dhiata e Vjetër, nuk ishte vetëm një dokument i shenjtë letrar dhe nuk ishte vetëm një depozitë e miteve të lashta dhe kujtimeve të përbashkëta, por ishte gjithashtu një kushtetutë e përdorur çdo ditë për të vendosur çështjen e sjelljes së përbashkët dhe individuale.

Prandaj, nuk është për t'u habitur që hebrenjtë arritën të jenë kombi i vetëm i antikitetit klasik, që kanë pasur një shkrim e këndim të vazhdueshëm. Veçanërisht pas

shkatërrimit të Tempullit të Dytë, pas humbjes së sovranitetit të tyre (vetëm disa dekada pas vdekjes së Krishtit), hebrenjtë i kthyen shkrimet e tyre të shenjta, Biblën, Mishna dhe Talmud, në një zëvendësim të atdheut, në një faltore dhe në një strukturë të qëndrueshme politike.

"Judaizmi është bërë një kulturë e të mësuarit, që e shndërroi tekstin në një tempull lëvizës", thotë profesori Moshe Halbertal i Institutit Shalom Hartman në Jerusalemin. "Profeti, i cili varej nga historia dhe prifti që varej nga ritualet dhe tempulli, u zëvendësuan nga studiuesi shembullor, i cili mund ta gjente Zotin në çdo nuancë që zbulonte në tekstet e shenjta".

Kështu që shkrimet e shenjta dhe të mësuarit, komentet dhe studimet, u bënë armët e fshehta të hebrenjve në luftën e tyre të vazhdueshme kundër asgjësimit kulturor. Në fakt, ata punuan më mirë se të gjithë legionet e Romës dhe gjithë fuqia e Perandorisë. Mund të thuhet se hebrenjtë i mbajti gjallë përkushtimi ndaj tekstit. Por kjo do të ishte e pamjaftueshme, sepse historia e tyre nuk ka të bëjë vetëm me fjalë. Dhe së fundmi, përndjekja dhe Holokausti si veprimi më i madh i persekutimit, përveçse zhduku "Çifutërinë evropiane", në fund të shekullit të 20-të, i dha një shpjegim të rëndësishëm fenomenit dhe forcës krijuese të identitetit hebre.

Shumë prej hebrenjve të Amerikës mendojnë për Ausvicin më shpesh sesa mendojnë për Jerusalemin. Kampet e përqendrimeve konkurrojnë me sinagogat si faltore të formimit të identitetit. Për sa i përket furnizimit me pika domethënëse referimi për një ndjenjë të sotme të hebraizmit, Spielberg tejkaloi

peshën e Maimonides.

Përndjekja shkaktoi mbijetesën. Profesor Israel Knohl shpjegon se "ne qëndruam së bashku, duke u martuar dhe duke mbajtur komunitete elastike, sepse në emër të Krishtit, johebrenjtë vazhdimisht përpiqeshin të na vrisnin, plaçkitnin ose shndërronin në besim. Ne mbetëm etnikisht të dëlirë sepse u përndoqëm. Ne mbijetuam përkundër persekutoreve tanë dhe mbijetuam për t'i përndjekur përndjekësit tanë".

Por, a mjafton kjo, shtron ai pyetjen. A do të mbijetojnë hebrenjtë për të parë fundin e mijëvjeçarit të tretë me forcën e kombinuar të kujtesës, Zotit, Biblës dhe persekutimit? Sot, shumë gjëra kanë ndryshuar. Asnjë pjesë e kompletit unik të mbijetesës nuk është ajo e mëparshme. Më pak se gjysma e hebrenjve do të rrëfenin sot për një besim të vërtetë në perëndinë e etërve të tyre. Përndjekja është në rënie. Dhe kujtesa e një vendi të largët nostalgjik është zëvendësuar nga Shteti i vërtetë i Izraelit, me pasojat që krijon një shtet. A do të ndjekin hebrenjtë, pasi janë bërë vetëm një komb tjetër historik, fenikasit dhe edomitët në harresë?

Mbase jo. Sepse, ashtu si vetë Krishti, ata janë të ndërthurur në histori. Ashtu si vetë Krishti, ata jo vetëm që kanë udhëtuar gjatë mijëvjeçarit, por edhe e kanë shkaktuar atë. Pra, për sa kohë që i numërojmë vitet ashtu si bëjmë, do të kujtojmë njeriun që u gabua si Mbret i Judejve. Dhe për sa kohë që ai do të kujtohet, hebrenjtë do të jenë aty për të dhënë versionin e tyre, i cili është shumë i ndryshëm nga ai, por megjithatë i lidhur shumë ngushtë me të. Ndoshta përjetësisht kështu.

/Telegrafi.com/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Superliga fillon me katër barazime

Pesë nga katër ndeshjet e javës së parë të Superligës së Kosovës në futboll përfunduan me rezultat të barabartë. E vetmja skuadër që shënoi fitore ishte Drita në përballje me Feronikelin. Kampionia në fuqi, Prishtina shpëtoi në fund nga humbja në përballje me Malishevën



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 22 GUSHT - Skuadra e Malishevës ka debutuar me barazim në Superligën e Kosovës në futboll, pasi luajti baras me Prishtinën me rezultat 1-1. Në minutën e 13-të, Vangjeli bëri një gabim amatoresk, kurse Hasan Hyseni e shfrytëzoi për mrekulli dhe shënoi për 1-0. Në minutat në vazhdim të dyja skuadrat patën rastet e veta, por asnjera nuk i shfrytëzoi deri në minutat shtesë. Në minutën e dytë shtesë, Donart Vitija u ndeshka me kartonin e dytë të verdhë dhe nga ndërprerja me se miri në zonë u gjend Leotrim Bekteshi që realizoi për 1-1. Në këtë mënyrë Malisheva e lëshoi nga duart fitoren e parë në Superligë. Në anën tjetër kampionët e Prishtinës duhet të kërkojnë fitoren e parë në edicionin e ri në xhiron e dytë, derisa në këtë ndeshje shpëtoi me shumë fat nga humbja. Ndeshja mes Ballkanit dhe Dukagjinit ka përfunduar me rezultat të

barabartë 2-2. Në minutën e 30-të, vendasit nuk arritën të kalojnë në epërsi, pasi Blend Baftiu nuk shënoi nga penalltia. Në fund të pjesës së parë, Ermal Krasniqi realizoi për 1-0, por Dukagjini u kundërpërgjigj nëpërmjet Arbër Shalës dhe pjesa e parë përfundoi 1-1. Në minutën e 54-të, Ermal Krasniqi e riktheu epërsinë e Ballkanit duke shënuar për 2-1. Në minutën e 68-të, Ahmed Januzi barazon rezultatit në 2-2. Sulmuesi Januzi e la skuadrën mysafire me një lojtarë me pak në pesëmbëdhjetë minutat e fundit, pasi u ndëshkua me karton të kuq. Ndeshja përfundoi me rezultat 2-2. Nënkampionet aktuale Drita ka arritur të fitojë me përmbyse ndaj Feronikelit (2-1). Skuadra nga Drenasi kaloi në epërsi me golin e Sokol Kiqinës, në minutën e 42-të, por më pas Ardit Tahiri realizoi dy herë, në minutat 77-të dhe 80-të për t'ia siguruar fitoren Dritës. Ndërkohë, fituesi i Kupës dhe Superkupës, Llapi e ka nisur me barazim edicionin e ri në


duel me skuadrën e ngjitur në Superligë, Ulpianën (1-1). Madje, të parët në epërsi kaluan mysafirët me golin e Argjend Mustafës, në minutën e 83-të, por llapjanët barazuan shifrat në minutat e fundit me golin e Alfer Firminos. Baras dhe me shifra të njëjta ka përfunduar edhe ndeshja në Skenderaj ndërmjet Drenicës dhe Gjilanit. Këtu të parët në epërsi kaluan vendasit me golin e Jose Denisson Silvës, në minutën e 16-të, derisa një pikë Gjilani e siguroi në saje të autogolit të Lushtakut, në minutat shtesë.

SUPERLIGA - Java e parë	
Malisheva - Prishtina	1-1
Ballkani - Dukagjini	2-2
Drita - Feronikeli	2-1
Drenica - Gjilani	1-1
Llapi - Ulpiana	1-1

Chelsea ia shkakton humbjen e dytë Arsenalit

LONDËR, 22 GUSHT - Chelsea e ka nisur mbarë këtë sezon të ri, duke fituar edhe ndeshjen e dytë, sërish ndaj një ekipi londinez, Arsenalit. Skuadra e Tuchel triumfoi me shifrat 2-0 në derbi. Romelu Lukaku zbriti në fushë për herë të parë në këtë rikthim dhe gjeti menjëherë

golin, duke tundur rrjetën në minutën e 15-të. Në të 35-tën shënoi edhe Reece James për blutë, duke i çuar shifrat në 0-2. Me të njëjtat shifra përfundoi gjithë ndeshja, me Chelsean, që ishte dukshëm më dominues se skuadra e Artetas.



SHKURT

Rashani shënon dy gola kundër Lyonit

Lyonit ishte duke fituar me dy gola diferencë ndaj Clermontit, por dy golat e reprezentuesit të Kosovës, Elbasan Rashani, ia mohuan fitoren dhe ndeshja përfundoi 3-3. Shënues për skuadrën e Lyonit ishin Moussa Dembele (5' 30') dhe Lucas Paqueta (45'), kurse për Clermontin dy gola i shënoi Rashani (80, 90+) dhe Sinaly Diomande (autogol). Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Elbasan Rashani, ka shënuar golin në ndeshjen ndaj Lyonit, të cilën Clermonti e humbi me rezultat 3-2.

Behije Mustafa fiton medaljen e bronzë në Kampionatin Evropian të karatesë

Karateistja Behije Mustafa ka fituar medaljen e bronzë në Kampionatin Evropian që po mbahet për kadetë, juniorë dhe U-21 në Tampere të Finlandës. Deri te medalja, garuesja jonë arriti pas katër fitoreve, në kategorinë e junioreve mbi 59 kg. Në luftën për të bronzën përmes repesazhit mundi Lara Zarei të Suedisë. Paraqitje të mirë kishte edhe Rinesa Osmani që doli e shtata në kategorinë e junioreve deri në 59 kilogramë. Rigon Baruti u rendit i nënti te juniorët në kategorinë deri në 68 kilogramë. Ekipi i karatesë po paraqitet me 17 garues, ndërsa licenca evropiane morën edhe dy gjyqtarët Edon Xharra dhe Astrit Ndrecaj.

Hysaj nuk u driblue asnjëherë në debutimin për Lazio

Lazio e nisi me këmbën e mbarë edicionin e ri të Serisë A teksa mposhti me rezultat 1-3 Empolin në transfertë. Ajo që ra më shumë në sy ishte paraqitja mbresëlënëse e mbrojtësit të kombëtares shqiptare, Elseid Hysaj, teksa ka zhvilluar një super ndeshje. Një debutim me Lazio pikërisht ndaj ish-skuadrës së tij, Empolit. Sipas asaj që tregon faqja e njohur e statistikave "Sofascore", Hysaj është vlerësuar me notën 7,6. Mbrojtësi i Shqipërisë luajti përgjatë gjithë 90-minutëshit teksa ka arritur të fitojë të gjashtë duellet me kundërshtarët, ta kapë topin katër herë dhe duke mos u dribluar asnjëherë, duke bërë kështu një debutim tepër pozitiv për Hysajn.

Vllaznia e femrave sfidon Juventusin

Vllaznia e femrave arriti një sukses historik duke u kualifikuar në fazën e "Play-off" -it të Championsit pasi eliminoi Ferencvaroshin me penallti vetëm dy ditë më parë. Ditën e sotme është hedhur shorti për raundin e dytë, teksa shkodranët kanë "peshkuar" një kundërshtar shumë të vështirë si Juventusin. Ndeshjet do të luhen më 31 gusht ose 1 shtator dhe e kthimit më 8 ose 9 shtator dhe fituesi do të sigurojë shumën e madhe të 400 mijë eurove. Pritet një tjetër performancë dinjitoze nga ana e Vllaznisë së femrave që ka treguar paraqitje prej një skuadre me vlera dhe histori.

Barça ndalet nga Bilbao, Koemani 'vajton' mungesën e Messit

BARCELONË, 22 GUSHT - Barcelona nuk ka arritur më shumë se një barazim 1:1 me Athletic Bilbao në ndeshjen e xhiros së dytë në La Liga, duke e bërë kështu gabimin e parë të sezonit. Pas ndeshjes, trajneri i Barcelonës, Ronald Koeman, pranoi se Messi do t'i nevojitej shumë

klubit në këso ndeshjesh. Nuk më pëlqen të flas gjithmonë për këtë, por ne po flasim për lojtarin më të mirë në botë", ka thënë fillimisht Koeman për gazetën "Marca". "Kundërshtari ka më shumë frikë kur Messi është aty. Nëse i jepni Leos një pasim, ai zakonisht nuk e humb topin.

Mund të thuash që ai nuk është këtu. Ne e dimë këtë, por nuk mund të ndryshohet", përfundoi holandezi. Golin e barazimit për Barcelonën e shënoi Memphis Depay duke e "bombarduar" portën kundërshtare me një goditje të fuqishme.



'Dardanët' e jashtëzakonshëm, triumfojnë në Evropianin në Prishtinë

PRISHTINË, 22 GUSHT - Kosova ka shënuar pesë fitore në pesë ndeshje, duke triumfuar në Evropianin në Prishtinë. Në finale dardanët kanë mundur Luksemburgun 43:86 (17:23, 12:17, 10:23, 4:23) në FIBA European Challenger. Fillimi i ndeshjes ishte i barabartë, por basketbollistët e Kosovës, të përkrahur edhe nga tifozët, u motivuan për t'u shpëputur 15:23, derisa çereku i parë përfundon 17:23. Kjo nuk i ndaloi basketbollistët e rinj të Kosovës të vazhdojnë me lojë të mirë. Ata luftuan për çdo top dhe luftuan me krenari, duke thëlluar edhe më shumë epërsinë dhe zhvilluan një lojë mjaft të bukur, duke shkuar në pushim me shifrat 29:40, kurse epërsia më e lartë në pjesën e parë ishte 26:40. "Dardanët" ishin të mrekullueshëm edhe në periodën e tretë, duke qenë



bindshëm më të mirë, ku e fituan këtë pjesë 10:23, ndërsa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 39:63. Kosova vazhdoi me lojë të mirë edhe në 10 minutat e fundit për të triumfuar bindshëm 43:86. Kosova përfundoi në vendin e parë, Luksemburgu në vendin e dytë, Moldavia dhe Malta në vendin e 3-të, përkatësisht 4, me dy fitore dhe tri humbje, kurse në vendet e fundit ishin

Gjibraltari dhe Shqipëria me nga një fitore dhe katër humbje. MVP i turneut u shpall Ron Dahsyla. Trofeun ia dorëzoi sekretarja e përgjithshme e Federatës së Basketbollit të Kosovës, Elvira Dushku, ndërsa trofeun e kampionit ia dorëzoi kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, Arben Fetahu. I pari i FBK-së pranoi edhe një çmim për organizimin e mirë të turneut në Prishtinë.

Greza: Mendova ta lë futbollin, Zoti dhe familja më ndihmuan

PRISHTINË, 22 GUSHT - Eros Greza shënoi një gol trepikësh kundër Debrecenit dhe Zalaegerszegi TE FC festoi gjatë pas ndeshjes. Më shumë nga të gjithë u gëzua sulmuesi anësor nga Gjakova, i cili ka vuajtur shumë prej dëmtimeve kohët e fundit. Greza tregohet i sinqertë dhe tregon se ka menduar edhe ta mbyllë me futbollin, pas operimeve të kryera që e bënë ta humbte të gjithë sezonin e shkuar. "Shumë probleme dhe lëndime në dy vjetet e fundit ma vështirësuan karrierën. Tre operacione në një vit shumë herë më bënë të mendoj që të dorëzohem nga



ëndrra ime. Besimi në Zot dhe familja që më ka mbështetur në çdo çast të jetës më kanë dhënë forcë që të kthehem më i fortë!

Sot është dita më e lumtur që bëra përsëri familjen time krenare me mua! Zoti është më i madhi", ka shkruar Greza.

SHKURT

Pacquiao mposhtet nga Uga me vendim unanimit

Yordenis Uga i Kubës shënoi fitoren më të madhe të karrierës së tij në boks të shtunën, pasi ai e mundi Manny "Pacman" Pacquiao në përballjen e tyre në peshën e mesme në T-Mobile Arena në Las Vegas. Ugas, i cili luftoi në njoftimin vetëm 11 ditë pasi Errol Spence Jr. duhej të tërhiqej për shkak të një dëmtimi në sy, bëri një mbrojtje të suksesshme të titullit të tij "super" në peshën e mesme në WBA. Rezultatet ishin 115-113, 116-112 dhe 116-112 për kubanezin, i cili ishte deri tani boksieri më i saktë në luftë. Kjo mund të jetë ndeshja e fundit për Pacquiao.

Goretzka qëndron edhe shumë vite në Bayern

Leon Goretzka do të vazhdojë të jetë lojtar i Bayern Munchenit edhe për pesë vjetet e ardhshme. Dilema për rinovimin e mesfushorit gjerman tani ka marrë fund, me lojtarin që ka vendosur të qëndrojë edhe për shumë vjet në Munchen. "Sky" shkruan se Goretzka do të firmosë në ditët e ardhshme një kontratë deri më 2026 me një pagë vjetore prej 15 milionë eurosh. Ai do t'i bashkohet kështu kolegut të tij, Joshua Kimich, që, gjithashtu, do të firmosë deri më 2025 me kampionët në fuqi. Këto mund të quhen pa dyshim dy blerjet më të rëndësishme në merkaton e verës për Bayernin që do të siguronte kështu shërbimet e dy prej mesfushorëve më të mirë gjerman në vitet e fundit.

Milani tenton transferimin e Bernardo Silvas

Bernardo Silva ka vendosur të largohet nga Manchester City gjatë afatit kalimtar veror. Ardha e Jack Grealish ka bërë që portugezi mos të shihet më si titullar nga Pep Guardiola dhe vetë lojtari ka kërkuar largimin nga klubi. Atletico Madrid, Tottenham Hotspur e Arsenal ishin skuadrat e interesuara për të por, së fundmi, garës i është bashkuar edhe Milani. "Rossonerët" nuk kanë mundësi që të shpenzojnë për blerjen përfundimtare të menjëhershme të tij dhe kanë kërkuar huazim. Mediumi anglez "Daily Star" ka zbuluar edhe ofertën që Milani u ka bërë kampionëve të Anglisë për yllin portugez. Kuqezinjtë i kanë ofruar Cityt 15 milionë euro për huazimin dyvjeçar të Bernardo Silvas me detyrim blerje në vitin 2023 për 35 milionë euro të tjera. Është një ofertë që është marrë në konsideratë nga City, derisa Paolo Maldini pritet të futet në bisedime edhe me lojtarin. 27-vjeçari është bashkuar me Cityn në verën e vitit 2017 nga Monaco për 50 milionë euro.

Braziliani Anderson rezikon 10 vjet burg

Nuk arriti kurrë të ishte një brazilian i vërtetë, nga ata lojtarë që të bëjnë të dashurohesh e që nuk është e lehtë ta harrosh, por Anderson ka qenë një futbollist jo pak i rëndësishëm për Manchester Unitedin nga viti 2007-2015. Në moshën 33 vjeçare, një vit më parë, Anderson vendosi të largohej nga futbollin i luajtur, por emri i tij është rikthyer fuqishëm në Brazil jo për futboll, por për një ngjarje të rëndë. Ish-mesfushori është ndalur në kuadër të një operacioni ku përfshiheshin edhe tetë persona të tjerë, një organizatë kriminale e cila merrej me vjedhje, zhvatje dhe pastrim parash. Sipas mediave braziliane, Anderson ishte pjesë e këtij grupi që ka zhvatur kompani të ndryshme, duke i shkaktuar një dëm prej 5 milionë eurosh, shumë kjo e cila më pas është pastruar duke blerë në treg kriptovaluta. Policia ka mësyrë në apartamentin e tij vitin e shkuar duke i konfiskuar edhe kompjuterin personal. Nëse ish-futbollisti brazilian shpallet fajtor, rezikon deri në 10 vjet burg.

Solskjaer: Unitedi nuk e shet Pogban

Trajneri i Manchester Unitedit, Ole Gunnar Solskjaer, ka këmbëngulur se Paul Pogba nuk do të largohet në këtë afat kalimtar. Pogba vazhdon të jetë i lidhur me një largim nga "Old Trafford", pasi Paris Saint-Germaini raportohet se e dëshiron reprezentuesin francez. Francezi është në vitin e fundit të kontratës së tij me Unitedin dhe Solskjaeri tha në korrik se

klubi ishte në bisedime për ta lidhur atë me një marrëveshje të re. Edhe pse Pogba nuk ka arritur një marrëveshje me Djajtë e Kuq deri më tani, Solskjaer nuk e sheh atë të largohet para se të mbyllet afati kalimtar më 31 gusht, shkruan "Goal". "Po, unë pres që Paul të jetë këtu kur të vijë 1 shtatori. Nëse keni një kontratë pesëvjeçare ose një kontratë njëvjeçare, kur nënshkruani për

Unitedin ju duhet të përballeni me sfidën e performancës në një nivel të qëndrueshëm. Nuk jam i shqetësuar fare se kohëzgjatja e kontratës së çdo lojtari po ndryshon nivelin e motivimit dhe frymëzimit të tyre. Ju dëshironi të luani mirë për ekipin tuaj, shokët tuaj të skuadrës, veten, familjen tuaj, sa herë që luani", ka thënë Solskjaer. "Ajo që pres

është që qëndrimi dhe qasja në çdo lojë të jetë e duhura. Se ne kemi të njëjtin fokus, fokusin e duhur, profesionalizmin e duhur dhe me këtë, nuk kam asnjë shqetësim për Pogban. Paul është duke shijuar futbollin e tij dhe e kam thënë shumë herë, puna ime është të sigurohem që po nxjerrim më të mirën nga ai dhe Bruno", ka deklaruar Solskjaer.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Datë:20.08.2021

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Qendrat e Kompetencës për vitin shkollor 2021/2022 Prishtinë, gusht 2021

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në Gjinnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2021/22, mund të konkurrojnë nxënësit, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftësive në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të shkollave profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për konkurs plotësues për Gjinnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2021/2022, bëhet më datën 23, 24 dhe 25 gusht 2021-në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 26.08.2021. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 27.08.2021.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit për të Rritur dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHTI - komisionit për ankesa. Për të gjitha Qendrat e Kompetencës vlen kriteri 24 nxënës për klasë.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | |
|--|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksese për gjinnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjinnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% e pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë

Lëndët me prioritet ne sukses sipas profileve ne IAAP

- Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari, Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Fizikë, Gjuhë angleze.
- Makineri, Elektroteknikë, TIK. Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi — Teknologji, PTT, Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë.

- Ekonomi, Administratë, Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi.
- Juridik: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë Angleze, Tregti, Hotelieri dhe Turizë, Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze, Shkenca shoqërore, Matematikë dhe Informatikë, Shkenca natyrore.
- Shkollat Artistike: Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze,, Shkenca shoqërore, Matematikë dhe Informatikë, Shkenca natyrore.
- Drejtimi pedagogjik - profili bashkëpunëtor muzikor: Nxënësi duhet ta këtë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar; Drejtimi instrumental: Nxënësi duhet ta këtë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII); Në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI). Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë.

4. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- Shkollat e shëndetësisë – mesatarja e lendeve: fizik, kimi, biologji dhe gjuhë amtare se paku duhet të jete 4 (katër), si dhe 40% te pikëve nga lendet prioritare ne test (10 pike nga lendet fizike, kimi dhe biologji).

1. Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

1. Shkencat natyrore 25	25 x 0.8 = 20 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25	25 x 0.4 = 10 pikë
3. Matematikë dhe informatikë 25	25 x 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkencat shoqërore 25	25 x 0.1 = 2.5 pikë
	Totali = 40 pikë

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi - Teknologji

1. Matematikë dhe Informatikë 25	25 x 0.8 = 20 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25	25 x 0.4 = 10 pikë
3. Shkenca natyrore 25	25 x 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkenca shoqërore 25	25 x 0.1 = 2.5 pikë
	Totali = 40 pikë

III. Ekonomi

1. Matematikë dhe Informatikë 25	25 x 0.8 = 20 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25	25 x 0.4 = 10 pikë
3. Shkenca shoqërore 25	25 x 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkencat natyrore 25	25 x 0.1 = 2.5 pikë
	Totali = 40 pikë

IV. Juridik

1. Shkencat shoqërore 25	25 x 0.8 = 20 pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25	25 x 0.4 = 10 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25	25 x 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkenca natyrore 25	25 x 0.2 = 5 pikë
	Totali = 40 pikë

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25	25 x 0.8 = 20 pikë
2. Shkenca shoqërore 25	25 x 0.4 = 10 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25	25 x 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkenca natyrore 25	25 x 0.1 = 2.5 pikë
	Totali = 40 pikë

VI. Shkollat Artistike

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25	25 x 0.8 = 20 pikë
2. Shkenca shoqërore 25	25 x 0.4 = 10 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25	25 x 0.3 = 7.5 pikë
4. Shkenca natyrore 25	25 x 0.1 = 2.5 pikë
	Totali = 40 pikë

**KONKURSI PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË QENDRAT E KOMPETENCËS
GUSHT 2021/22**

Mësimi në gjuhën shqipe

Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	Paralelet	Nr. nxënësve	Vitet		
Prizren	"11 Marsi"	Elektroteknikë	Dizajn Softwerik	1	5	2+1		
			Informatikë	1	7	2+1		
			TIT (Tekn. Inf. dhe telekomunikac.)	1	17	2+1		
			Instalues elektrik	1	14	2+1		
			Mekatronikë	1	19	2+1		
			Teknik i elektronikës	1	24	2+1		
			Teknik i sistemeve të IT	1	10	2+1		
		Makineri	Trafik rrugor	1	3	2+1		
			Automekanikë	2	22	2+1		
			Metalpunues/Saldues	1	22	2+1		
		Ndërtimtari	Arkitekturë	1	3	2+1		
			Teknik i izolimit të ndërtesave	1	24	2+1		
		Arte te aplikuar	Teknik i Dizajnit Grafik	1	4	2+1		
			Dizajn enterieri	1	11	2+1		
		Gjithsej - Sh. "11Marsi" Gj. shqipe				22	185	2+1
		Mësimi në gjuhën boshnjake						
		Makineri	Trafik rrugor	1	8	2+1		
			Elektronikë	TIT	1	17	2+1	
		Arte të aplikuar	Dizajn tekstili dhe veshjeve	1	14	2+1		
			Gjithsej- Gj. Boshnjake	3	39	2+1		
Mësimi në gjuhën turke								
Elektronikë	TIT (Tekn. Inf. dhe telekomunikac.)	1	2	2+1				
	Gjithsej- Gj.Turke				2	22+2=24	2+1	
Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	Paralelet	Nr. Nxënësve	Vitet		
Prishtinë	Sh.M.L.P "Shtjefën Gjeçovi"	Makineri	Metalpunues	2	40	2+1		
			Mekatronikë	1	12	2+1		
		Transport dhe Trafik	Trafik Rrugor	1	9	2+1		
			Transport Rrugor	1	19	2+1		
			Lëvizje e Trenave	1	10	2+1		
Gjithsej - "Sh. Gjeçovi"				6	90	2+1		
Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	Paralelet	Nr. Nxënësve	Vitet		
Prizren	Qendra e Kompetencës	Biznes (Ekonomi & Tregti)	Nëpunës industrie	1	24	2+1		
			Nëpunës finance	1	24	2+1		
			Nëpunës Administrim zyre	1	24	2+1		
			Nëpunës i eksport-import	1	24	2+1		
		Turizëm	Udhëheqës i udhëtimeve dhe grupeve turistike	1	24	2+1		
			Asistent ne zyra informimi dhe agjenci turistike	1	24	2+1		
			Asistent në organizimin e ngjarjeve (Evenimenteve)	1	24	2+1		
		TIK	Teknik i informatikës së biznesit	1	24	2+1		
Gjithsej - QK - Prizren				8	192			
Vendi	Shkolla	Drejtimet	Profillet	Paralelet	Nr.Nxënësve	Vitet		
Malishevë	Qendra e Kompetencës	Administratë	Administratë dhe shërbime të zyrës	1	25	2+1		
			Ekonomi	Banka dhe shërbime të sigurimeve	1	21	2+1	
		Shitje dhe marketing		1	20	2+1		
		Logjistikë dhe operim në magazinë		0	10	2+1		
		Shërbime të TIK-ut		0	13	2+1		
		Hoteleri dhe turizëm		0	12	2+1		
Gjithsej - QK - Malishevë				3	101			



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e një (1) anëtarit të Bordit për Ankesa të Komisionit të Pavarur për Media

Përgjegjësitë dhe kompetencat

Bordi për Ankesa shqyrton ankesat e palëve ndaj vendimeve të KPM-së, që drejtpërdrejt i nënshtrohen vendimit, sa i përket:

- Dhënies, refuzimit, mosripërtërimit ose revokimit të lejes transmetuese;
- Vënies ose ndryshimit të kushteve të lejes së transmetimit, me përjashtim të kushteve që kanë të bëjnë me caktimin e frekuencave apo kritereve të tjera teknike;
- Shqiptimit të sanksioneve dhe çështjeve tjera të ngjashme, që mbështeten në aktet nënligjore;
- Bordi i Ankesave mund të mbështesë, ndryshojë ose shfuqizojë çdo vendim të KPM-së, duke vepruar sipas ankesës për vendimin përkatës.

Kandidatët për anëtarë të Bordit duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të kenë vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Të kenë së paku diplomë universiteti në fushën e drejtësisë;
- Të kenë provimin e dhënë të judikaturës;
- Të kenë minimum pesë (5) vjet përvojë profesionale në fushën e avokaturës, çështjeve gjyqësore, ligjit administrativ, rregullimin e mediave apo politikën rregullative;
- Të jenë figura eminente, me karakter dhe moral të lartë, paanshmëri e integritet, përkushtim të dëshmuar të administrimit të duhur të drejtësisë;
- Të mos kenë pengesa në kuptim të nenit 39 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

Kandidatët të plotësojnë dhe nënshkruajnë vetë-deklaraten, që i përmbushin të gjitha kriteret e pranueshmërisë në nenin 39 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

Anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen me mandat tre (3) vjeçar dhe mund të rizgjedhen vetëm edhe për një mandat tjetër.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Letra motivuese;
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës (duke bashkëngjitur edhe raportin nga Trusti pensional);
- Deklaratën e plotësuar dhe të nënshkruar;
- Certifikatën që kandidati nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj).

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 06.09.2021, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosova, objavljuje

KONKURS

Za izbor jednog (1) člana Borda za žalbe u Nezavisnu komisije za medije

Odgovornosti i nadležnosti

Bord razmatra žalbe stranaka protiv odluka NKM-a, koje neposredno podležu odlukama koje se odnose na:

- Izdavanje, odbijanje, ne produžavanje ili oduzimanje dozvola za emitovanje;
- Postavljanje ili izmenu uslova dozvole emitovanja, izuzev uslova koji se odnose na određivanje frekvencija ili drugih tehničkih kriterija;
- Izricanje sankcija i slično, na osnovu pod zakonskih akata.
- Bord za žalbe može podržati, izmeniti ili staviti van snage svaku odluku NKM-a, postupajući prema žalbi protiv određene odluke.

Kandidati za člana Borda moraju ispuniti sledeće uslove:

- Mora biti državljanin Republike Kosova i stalno nastanjeni na Kosovu;
- Da imaju minimum univerzitetsku diplomu iz oblasti prava;
- Da imaju položen pravosudni ispit;
- Da imaju najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti advokature, sudstva, uprave, regulisanju medija ili u regulatornoj politici;
- Da su eminentne ličnosti visokog karaktera, morala, integriteta, nepristrasni i dokazano privrženi administriranju pravde;
- Da nemaju prepreka u smislu člana 39 Zakona o NKM;

Kandidati popune i potpišu svoju deklaraciju, da ispunjavaju sve uslove saglasnosti u skladu sa članom 39. Zakona o nezavisnoj Komisiji za medije.

Članovi Odbora za žalbe imenuju se trogodišnjim mandatom uz mogućnost reizbora za samo još jedan mandat.

Uz aplikaciji trebaju se priložiti sledeća propratna dokumenta:

- Curriculum Vitae (CV - autobiografija);
- Dokaz o školskom i stručnom obrazovanju (diplome iz stranih univerziteta moraju biti nostrifikovane od Ministarstva za obrazovanje, nauku i tehnologiju);
- Motivaciono pismo;
- Dokaz o državljanstvu Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu (prilaže i izveštaj od Trusta penzijske štednje);
- Popunjenu i potpisanu deklaraciju; i
- Certifikat da kandidat nije pod istragom (ne starije od 6. meseci).

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 06.09.2021. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 10, paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, prej tyre së paku dy (2) anëtar duhet të jenë nga radhët e komuniteteve tjera joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtar duhet të jenë të gjinisë femërore

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Këshilli) është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili vendos për ankesat e nëpunësve, si dhe siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Përbërja e Këshillit

Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që zgjedhën nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prej tyre, së paku dy (2) anëtar zgjedhën nga komunitetet joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtar duhet të jenë të gjinisë femërore.

Funksionet e Këshillit :

- Mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- Shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil;
- Mbikëqyr procedurën e përzgjedhjes dhe vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil;
- Monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Kandidati që aplikon për tu zgjedhur anëtar i Këshillit duhet të ketë kualifikimet dhe të plotësojë kriteret në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë diplomë të fakultetit juridik të vlefshme sipas ligjit në fuqi;
- Të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave së paku pesë (5) vite përvojë pune në shërbimin civil;
- Të ketë të kryer provimin e jurisprudencës;
- Të jetë njohës mirë i legjislacionit në fuqi;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil me vendim përfundimtar.

Mandati i anëtarëve të Këshillit

- Anëtarët e Këshillit zgjedhën për mandat shtatë (7) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes për mandat tjetër.
- Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër shtetëror, të jetë anëtar i partisë politike apo të marr pjesë në aktivitetet politike.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 13.09.2021, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Skupština Republike Kosova, na osnovu člana 10, Zakona br. 06/L-048 o Nezavisnom nadzornom odboru civilne službe Kosova raspisuje:

KONKURS

Za izbor sedam (7) članova Nezavisnog nadzornog odbora civilne službe Kosova, od kojih najmanje dva (2) člana trebaju biti iz redova ostalih ne većinskih zajednica i najmanje dva (2) člana trebaju biti ženskog pola

Nezavisni nadzorni odbor za civilnu službu Kosova (Odbor) je nezavisni organ, koji izveštava Skupštini Republike Kosova, rešava žalbe zaposlenih i obezbeđuje poštovanje pravila i načela koja regulišu civilnu službu.

Sastav Odbora

Odbor se sastoji od (7) članova, koje bira Skupština Republike Kosova.

Od toga, najmanje (2) člana biraju se iz ne albanskih zajednica i najmanje (2) člana treba da budu ženskog pola.

Funkcije Odbora:

- Nadgleda primenu pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi.
- Razmatra i rešava žalbe civilnih službenika i kandidata za prijem u civilnu službu.
- Nadgleda proceduru izbora i odlučuje da li su imenovanja civilnih službenika visokog upravnog nivoa i upravnog nivoa, odvijane u skladu sa pravilima i načelima zakonodavstva o civilnoj službi;
- Nadgleda institucije javne administracije, koje su zaposlile civilne službenike u vezi sprovođenja pravila i načela zakonodavstva o civilnoj službi;

Kandidati koji apliciraju za izbor člana Odbora, mora da budu kvalifikovani i da ispunjavaju sledeće kriterijume:

- Da je državljanin Republike Kosova,
- Da je diplomirani pravnik, prema važećem zakonodavstvu, koje je na snazi;
- Da poseduje najmanje deset (10) godina stručnog radnog iskustva, od kojih najmanje pet (5) godina rada u civilnoj službi,
- Da je završio pravosudni ispit;
- Da je dobar poznavalac važećeg zakonodavstva,
- Da nije kažnjavan pravosudnom odlukom za počinjeno namerno krivično delo;
- Da prema njemu nije konačnom odlukom preduzeta disciplinska mera udaljanja iz civilne službe.

Mandat članova Odbora

- Članovi odbora se imenuju za sedmogodišnji (7) mandat, bez mogućnosti ponovnog izbora za još jedan mandat,
- Član odbora nema pravo da u toku svog mandata obavlja drugu državnu funkciju, da bude član političke partije ili da učestvuje u političkim aktivnostima.

Uz aplikaciju moraju se priložiti sledeća propratna dokumenta

- Dokaz o školskoj i profesionalnoj spremi,
- Motivaciono pismo,
- Curriculum Vitae (CV-autobiografija),
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova.
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 13.09.2021. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majka Tereza“ bb. ili u

Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Sara Pruthi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.
- ▶ "Phone Calls" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70588307.
- ▶ Shkumbin Hetemi B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811541037.
- ▶ D.P.Z. "Drini i Bardh" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 80199082 si dhe nr. fis: 600480305.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- ▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- ▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- ▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- ▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- ▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- ▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- ▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

